Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Agnese Ibrahimi	**18.12.2023**	**01.01.2024**	**2023/1004**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 11.12.2023, OE "NIKA PrO- Ing SH.P.K."- Ferizaj, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/1004, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "HIDROING 2SH SH.P.K."- Gjilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Renovimi i objekteve shkollore ne Kamenice, Topanice, Koretin,Karaçeve,Busavate, Hodonoc, Çerdhje ne Kamenice-Ritenderim" me nr. të prokurimit: "KM653-23-11643-5-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E KAMENICËS.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 168,033.87 €.

Fazat e procedurës së prokurimit:

Njoftimi për kontratë: 24/10/2023

Hapja e ofertave: 03/11/2023

Vendimi i AK-së: 17/11/2023

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë nuk është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/1004 i dt:11.12.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 i LPP-së

Neni 6 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 59 i LPP-së

Neni 72 i LPP-së

Jemi njoftuar me dt. 17.11.2023 se AK ka rekomanduar per kontrate OE Hidroing 2 Sh.P.K. i cili eshte me cmim me te larte se oferta jonë e dorezuar me dt. 03.11.2023

AK- na ka kthyer pergjigje gjate kerkes per ri-shqyrtim per nje projekt tjeter,

- **Pretendimi 1.** Keni shkelur Nenin 1 të LPP-së (Qëllimi) Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

AK në këtë raste e ka shpallur fitues OE më të shtrejt se oferta e OE ankues në vlere prej 6,548.72€ duke e dëmtuar bugjetin e shtetit

Pretendimi 2. Keni shkelur Nenin 6 të LPP-së (**Ekonomiciteti dhe Efikasiteti**) Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

- **Në këtë rastë AK Komuna e Kamenicës e ka shkelun nenin 6 të LPP-së duke shpallun fitues me qmim më të shtrejtë**
- **OE i shpallun fitues 160,425.72€**

Pretendimi 3. Keni shkelur Nenin 7 të LPP-së (Barazia në Trajtim / jo - Diskriminim) Auturiteti kontraktues do ti trajttoj operatoret ekonomik në mënyrë të barabart dhe jo diskriminuese dhe do të veproj në mënyrë transparente.
AK nuk ka vepruar në mënyrë të barabart për faktin se edhe pse sipas nesh jemi të përgjegjshem, ne jemi eliminuar padrejtesishtë.

Argumentet dhe faktet

Pretendimi 4. AK na ka eliminuar në kundershtim me LPP dhe RROUP pasi ne e kemi në listen e dorezuar z. Isa Shabani si inxhinjer i elektros i cili ka diplomuar 24.12.1987 dhe i njejti e ka pervojen mbi 35 vite si inxhinjer i elektrose dhe ne listen e dorezuar per kete projekti e kemi cekun se inxhinjer ne fjale ka pervojen e kerkuar në DT.

NIKA PROING

Titulli: Renovimi i objekteve shkollore në Kamenicë, Topanicë,Koretin,Karaçevë,Busavatë, Hodonoc, Çerdhje në Kamenicë -Ritenderim

Nr. Prokurimit: KM653-23-11643-5-2-1
AK: KOMUNA E KAMENICËS

Nr	Emri & Mbiemri	Profesioni	Pozicioni	Mosha	Pervoja
1	Flamur Hajrullahu	Ing-Arkitekturës	Menaxher Projekti	51	18
2	Bekim Reznepi	Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë Drejtimi Konstruktiv	Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë Drejtimi Konstruktiv	54	28
3	Fehmi Hodeli	Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë – Drejtimi Hidroteknik	Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë – Drejtimi Hidroteknik	58	14
4	Isa Shabani	Inxhinier i diplomuar i Elektroteknikës – Drejtimi Elektronik	Inxhinier i diplomuar i Elektroteknikës – Drejtimi Elektronik	65	36

Pretendimi 5. AK na ka eliminuar në kundershtim me LPP dhe RROUP pasi ne e kemi dorëzuar listen e puntorve me certifikata z. Flamur Dubova dhe z. Laurin Tahiri të cilet jane ne listen e dorezuar ne AK- per aresyje teknike nuk jane ngarkuar ne DT. Mirpo me sqarimet e kerkuara AK ka mundu te kerkoj sqarim.
Lsita e makinerise njejt eshte e dorezuar ne AK- per aresyje teknike nuk eshte ngarkuar mirpo AK me leter sqarim duker perdore nenet e larte cekura munde te kerkoj sqarim pasi jemi OE me e lire se OE i shpallun fitues.

Gjithe her AK duhet te veproj konforme LPP-se dhe RROUP po duke e pasur per baze Nenin

KRITERET PËR VLERËSIM

Kapaciteti teknik dhe professional:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare*
Kërkesa .1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së njëjtë apo të ngjashme gjatë 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit të njoftimit për kontratë) jo më pak se 168,000.00€	**Dëshmi .1-Operatori Ekonomik duhet të ofroj listën e kontratave të nënshkruar dhe realizuara të natyrës se njëjte apo të ngjashme gjatë 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate), të nënshkruar dhe vulosur nga Operatori Ekonomik, të dëshmuara me referenca ose raporte përfundimtare të pranimit teknik në kopje të nënshkruar dhe vulosur nga Autoritet përkatëse, për punët e realizuara dhe pranuara , të cilat duhet të tregojnë, numrin e prokurimit ose kontratës, vlerën e kontratës, datën e nënshkrimit të kontratës, natyrën e punës dhe vendin e realizimit të punëve.**
Kërkesa .2-Lista e stafit profesional të operatorit ekonomik me përbërje si ne vijim •Një (1) Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë ose Arkitekturës ose Master, me minimum përvojë pune 3 vite pas diplomimit. •Një (1) Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë – Drejtimi Hidroteknik ose Master, me minimum përvojë pune 3 vite pas diplomimit, •Një (1) Inxhinier i diplomuar i Elektroteknikës – Drejtimi Elektronik ose Master, me minimum përvojë pune 3 vite pas diplomimit	**Dëshmi. 2-Lista e stafit profesional duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga OE dhe dëshmitë për secilin inxhinierë si ne vijim •Kontrata ose para kontrata e punës valide me punëdhënësin. •Diploma e inxhinierëve përkatës sipas lëmis së kërkuar e noterizuar. •CV-it- e inxhinierëve të nenshkrara. •Referencat mbi përvojën e punës (në referenca duhet të jenë të saktësuara vitet e punës nga secili punëdhënës), •Për Gjeodet duhet te jetë edhe Licenca e punës valide.**

•Një (1) Gjeodet i diplomuar, i Licencuar, me minimum përvojë pune 3 vite pas diplomimit.	
Kërkesa .3-Operatori Ekonomik duhet të caktoj një menaxher të projektit me profesion inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë – konstruktiv ose inxhinierë i arkitekturës apo Master i cili duhet të këtë përvojë pune minimumi 3 vite pas diplomimit. **Menaxheri mund të jetë njeri nga stafi i prezantuar më lartë. OE duhet të ofroj listën e së paku 5 punëtorëve.** **Operatori ekonomike duhet të angazhoj punëtor të tjerë si në vijim** **a) 1 person të çertifikuar në hidroizolim** **b) 1 mjeshtër të kulmeve të çertifikuar**	**Dëshmi .3-Vendim me shkrim për caktimin e menaxherit të projektit (mundet të jetë njëri nga stafi profesional i prezantuar) - i nënshkruar dhe vulosur nga Operatori Ekonomik, kontrata ose para kontrata e punës valide me punëdhënësin, diploma e noterizuar, CV dhe referencat mbi përvojën e punës (në referenca duhet të jen të saktësuara vitet e punës nga secili punëdhënës)** **Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi Listën e punëtorëve të kompanisë me të dhënat në vijim Emri , mbiemrin dhe pozicioni në kompani, e nënshkruar dhe i vulosur nga OE. OE duhet të ofroj dëshmi për punetorët e trajnuar për siguri në punë, certifikatat të lëshuara nga një kompani e licensuar nga MPMS Deshmi çertifikatat për profilet e kërkuara (Për stafin dhe punëtorët të cilet janë jasht listës së punëtorëve të deklaruar me ATK të ofrohen kontrata ose marrevfeshje bashkepunimi për këtë projekt.**

Kërkesa.4. Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe i certifikuar me iso standarde si në vijim a) ISO 9001-2015 - b) ISO 14001-2015 ; d) ISO 45001 -2018, OE të jetë i certifikuar me ISO standartet ndërkombëtare për ndërtim i. ISO 9001 per Menaxhimin e Cilësisë, ii. ISO 14001 për Menaxhim të Mjedisit iii. ISO 45001 për menaxhimin e sigurisë dhe shëndetit në punë.	**Dëshmia.4. Kopjet e certifikatave të noterizuara**
Kërkesa -5-OE duhët ta ofrojë listën mbi mjetet e punës e nënshkruar dhe vlerësuar nga OE me pajisjet në vijim •Një (1) Kamionetë, • Një (1) Pick-Up • Një (1) Demolues Betoni, • Një (1) Aparat Saldimi, • Një (1) Gërryese e Gledit, • Një (1) Spërkatëse për ngjyrë, • Një (1) Thithëse e veqantë për pastrimin e estrihut.	**Dëshmi. 5- OE duhet të ofrojë listën e pajisjeve të kërkuara për ekzekutimit të punëve e vulosur dhe nënshkruar, për automjetet që kanë regjistrim të dëshmohet me librezë valide ose dud doganor dhe foto,ndërsa për pajisjet tjera të dëshmohet me foto dhe deklaratë mbi posedimin e tyre apo marrëveshje mbi marrjen me qera për projektin në fjalë.**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

V E N D I M

1. **Refuzohet si e pabazuar** kërkesa e O.E **Nika Proing Sh.P.K.** . SH.P.K për rishqyrtimin të vendimit për aktivitetin e prokurimit **"Renovimi i objekteve shkollore në Kamenicë,Topanicë,Koretin,Karaçevë,Busavatë, Hodonoc, Çerdhje në Kamenicë-Ritenderim."** parashtruar nga përfaqesuesi i O.E **Nika Proing Sh.P.K.**

2.Mbetet në fuqi vendimi i datës **17.11.2023** nga autoriteti kontraktues për aktivitetin e prokurimit **"Renovimi i objekteve shkollore në Kamenicë,Topanicë,Koretin,Karaçevë,Busavatë, Hodonoc, Çerdhje në Kamenicë Ritenderim.""** me nr të prokurimit **KM653-23-11643-5-2-1**

A r s y e t i m

Përgjigje në pretendimet tuaj ankimore- *Në të gjitha pretendimet tuaja ankimore ju arsyetoheni se është dashur të kërkohen sqarime shtesë dhe në kërkesën për rishqyrtim nuk keni paraqitur asnjë dëshmi apo prove që I vërteton të kundërtat .A.K qëndron mbrapa vendimit dhe arsyetimit të dates 17.11.2023 me arsyetimin si në vijim :*

Për pikat e cekura nuk lejohet ti kerkohet informata shtese ne pajtim me nenin si ne vijim:

Neni 72

Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

1. Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim

material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues.

Ankesa juaj refuzohet dhe cilësohet si pabazuar .

Udhëzimi juridik: Kundër ketij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese prane OSHP-se në afat prej 10 ditesh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi hynë në fuqi ne ditën e nënshkrimit.
Vendimi i dorzohet :
-palës,përmes platformës e-Prokurimit dhe adreses elektronike

Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit

Urim Thaqi

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

n/a

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

n/a

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

n/a

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **NIKA PrO- Ing SH.P.K.**

Sqarim hyrës: OE ankues ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së, kundër vendimit të AK-së. OE ankues ka parashtruar disa pretendime, ku dy prej tyre janë pretendime ankimore, për të cilat eksperti ka dhënë përgjigje si më poshtë.

Pretendimi 1, 2 dhe 3

Sa i përket këtyre tre pretendimeve të para të ngritura, eksperti sqaron se këto pretendime nuk janë pretendime ankimore, sepse nuk është paraqitur asnjë fakt apo provë konkrete, të cilat do të mund të shqyrtoheshin nga eksperti shqyrtues. Për pretendimet ankimore eksperti shqyrtues do të jap përgjigje si më poshtë.

Pretendimi 4

OE ankues pretendon se: *"AK na ka eleminuar ne kundërshtim me LPP dhe RROUP pasi ne e kemi në listën e dorëziar z. I.SH si inxhinier i elektros, i cili ka diplomuar 24.12.1987 dhe i njejti e ka pervojen mbi 35 vite si inxhinier i elektros dhe ne listen e dorezuar per kete projekti e kemi cekun se inxhinier ne fjale ka pervojen e kerkuar ne DT."*

Eksperti sqaron se një nga kërkesat e DT-së ka qenë që operatorët në kuadër të stafit të tyre profesional të kenë edhe një inxhinier të elektroteknikës, drejtimi elektronikë dhe i njëjti duhet të ketë përvojë pune të paktën 3 vite pas diplomimit, kjo përvojë është kërkuar të dëshmohet me referenca ku saktësohen vitet e punës nga secili punëdhënës. OE ankues në listën e stafit të saj profesional ka përfshirë edhe inxhinierin e elektroteknikës, mirëpo si dëshmi për përvojën e tij të punës ka ofruar vetëm një referencë në të cilën theksohet se i njëjti ka qenë i angazhuar në një ndërmarrje për periudhën 03/03/2014-31/11/2015 (Dëshmi: pika 4 e ofertës së OE ankues), e cila periudhë nuk e përmbushë kohën e përvojës së kërkuar. Përveç kësaj reference, për këtë inxhinier operatorit ankues nuk ka ofruar asnjë dokument apo referencë tjetër. Mirëpo, në bazë të nenit 72 të LPP-së, AK është dashur që të kërkoj sqarime shtesë, po gjithmonë duke pasur parasysh se çdo dokument i ofruar duhet që në mënyrë objektive të dëshmohet se ka ekzistuar edhe para hapjes së ofertave. Andaj, vlerësojmë se ky pretendim është i bazuar.

Pretendimi 5

"AK na ka eleminuar ne kundershtim me LPP dhe RROUP pasi ne e kemi dorezuar listën e punëtorëve me certifikata z. F.D dhe z. L.T të cilët jane ne listen e dorezuar në AK, per arsye teknike nuk jane ngarkuar ne DT. Mirëpo me sqarime e kerkuara AK ka mundu te kerkoj sqarim. Lista e makinerisë njejtë eshte e dorezuar ne AK, per arsye teknike nuk eshte ngarkuar mirepo AK me leter sqarim duke perdure nenet e larte cekura mund te kerkoj sqarim pasi jemi OE me i lire se OE i shpallun fitues."

Eksperti shqyrtues sqaron se disa nga arsyet e tjera pse OE ankues është eleminuar nga ky aktivitet prokurimi është edhe mos dorëzimi i dokumenteve të tjera të kërkuara si dëshmi në dosjen e tenderit, përfshirë certifikatat dhe marrëveshjet e punës për dy nga stafi i certifikuar, pastaj nuk janë dorëzuar asnjë nga dëshmitë e kërkuara për asnjë pajisje të kërkuar në dosje

dhe të përfshirë edhe në listën e pajisjeve. Mendimi i ekspertit është se OE ankues në këtë rast është treguar jo serioz dhe aspak i kujdesshëm në përmbushjen e kërkesave të DT-së.

Sa i përket certifikatave për stafin e certifikuar AK ka mundur të kërkojnë sqarime shtesë sepse të njëjtat e kanë një datë të fikësuar e cila mund të vërtetohet nëse ka ekzistuar edhe para hapjes së ofertave, por e njëjta nuk mund të thuhet edhe për marrëveshjet e angazhimit, ku sipas ekspertit, verifikimi i ekzistimit të këtyre marrëveshjeve është shumë i vështirë. Pra, konsiderojmë që ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

Po ashtu, sa i përket pajisjeve/mjetet e punës është kërkuar që operatorët përveç listës së pajisjeve të dorëzojnë edhe dëshmi për këto pajisje, përfshirë librezat apo dudad doganor për pajisjet që regjistrohen, apo për pajisjest të cilat nuk regjistrohen të ofrohen deklarata të posedimit apo marrëveshje mbi marrjen me qera. Sipas ekspertit duke marr parasysh se OE ankues ka ofruar vetëm një listë të pajsijeve, ndërsa për të njëjtat nuk ka ofruar asnjë dëshmi të kërkuar, dhe duke marr parasysh se për të kërkuar sqarime shtesë përmes nenit 72, AK duhet që në mënyrë objektive të vërtetoj që të njëjtat dokumente kanë ekzistuar edhe para hapjes së ofertave, mendimi i ekspertit është që për pajisjet të cilat regjistrohen edhe mund të verifikohet një gjë e tillë, por jo edhe për ato të cilat nuk regjistrohen. Çdo marrëveshje e cila mund të lidhet me një operator tjetër, për marrjen me qera të pajisjeve të caktuara, është shumë e vështirë të verifikohen se kanë ekzistuar edhe para hapjes së ofertave, ku sipas listës së bashkëngjitur në ofertë, OE ka deklaruar se ka pajisje të cilat i ka marr me qera, në DT nuk është kërkuar që këto marrëveshje të jenë të noterizuara gjë që do t'a lehtësonte mjaft shumë verifikimin e tyre. Edhe ky pretendim vlerësojmë se është pjesërisht i bazuar.

Për më tepër, eksperti edhe njëherë sqaron se mungesa e shumë dokumenteve në ofertën e dorëzuar nga OE ankues, tregon një përgjegjësi dhe seriozitet të ulët të OE ankues. Përmes LPP-së mund të kërkohen informata shtesë për dokumente të cilat janë të pakuptueshme, të gabueshme apo mungojnë, dhe të cilat janë lehtë të verifikueshme se kanë ekzistuar edhe para hapjes së ofertave, mirëpo dorëzimi i shumë dokumenteve pas hapjes së ofertave, sipas mendimit të ekspertit përbënë pasurim të ofertës fillestare të operatorit, gjë që vlerësojmë se nuk përbënë një trajtim të drejtë nëse krahasojmë me operatorët e tjerë pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, ashtu siç e kërkon edhe neni 7 i LPP-së.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, ndërsa Vendimi i AK-së të mbetet në fuqi.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA E KAMENICËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **NIKA PrO- Ing SH.P.K.**

REPUBLIKA E KOSOVËS
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PRISHTINË/A
REPUBLIKA KOSOVA

Agnese Ibrahimi

Ibrahimi